

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE S.E.R.E SH.P.K.
ME SELI NË RR. DERVISH HIMA, PALLATI AMBASADOR 3, KATI 8, TIRANË, SHQIPËRI
REGJISTRUAR PRANË REGJISTRIT TREGTAR ME NUMËR UNIK IDENTIFIKIMI
L22022002F

VENDIM

I

ASABLESE SE PERGJITHSHME TE SHOQERISE

Sot, më 24.08.2020, h. 14.00 në selinë e Shoqërisë **S.E.R.E. Sh.p.k.** (më tej referuar si "**Shoqëria**"), një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e cila zotërohet në masën 100% të kapitalit të saj nga shoqëria "**BFI Invest**" shpk, me NIPT L51721007Q, e cila zotërohet në masën 100% të kapitalit të saj nga shoqëria "**Balfin**" sh.p.k. (më tej referuar si "**Ortaku i Vetëm**"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

- **Balfin sh.p.k.**, legjislacionin shqiptar, me NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 11, ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, me ortak të vetëm, Z. Samir MANE, e cila zotëron 100% të kapitalit të Shoqërisë, e përfaqësuar ligjërisht nga znj. Edlira Muka në cilësinë e administratores së shoqërisë Balfin sh.p.k.

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Itena Ndroqi e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaroi Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim

RENDI I DITËS

1. **Miratimin e Bashkimit me Përthithje mes shoqërisë përthithëse SERE SH.P.K. dhe shoqërisë së përthithur BFI INVEST SH.P.K;**
2. **Miratimi i garancive për kreditorët eventual dhe shkarkimi i administratorëve nga çdo përgjegjësi; dhe**
3. **Të ndryshme.**

1. **Miratimin e Bashkimit me Përthithje mes shoqërisë përthithëse SERE SH.P.K. dhe shoqërisë së përthithur BFI INVEST SH.P.K;**

Duke kaluar në diskutimin çështjes së parë të Rendit të Ditës, Kryetari u kujton të pranishëmve se:

- BFI INVEST SH.P.K. zotëron 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë SERE SH.P.K.;
- në datë 1 Korrik 2020, administratori BFI INVEST SH.P.K. sëbashku me administratorin e shoqërisë SERE SH.P.K., kanë nënshkruar raportin e bashkimit me përthithje, sipas të cilit Shoqëria do të përthithë shoqërinë të kontrolluese BFI INVEST SH.P.K., i cili i bashkëlidhet këtij vendimi (në vijim "**Raporti i Bashkimit me Përthithje**")
- sipas Raportit të Bashkimit me Përthithje, bashkimit synon reduktimin e kostove të administrimit dhe optimizmin në tërësi të pasurive/mjeteve të shoqërive të përfshira në këtë operacion;



- sipas nenit 225, paragrafi 2, i Ligjit nr. 9901, me datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (në vijim "Ligji Tregtar") dhe në veçanti, sikurse rezulton nga projekt marrëveshja e bashkimit dhe vendimet e asambleve përkatëse, duke qenë se bëhet fjalë për një formë të tërthortë bashkimi:
 - a. nuk do të ketë ndryshime në statutit të shoqërisë përthithëse;
 - b. kapitalit i shoqërisë përthithëse do të zmadhohet në vlerën 5,000,000 Lekë ;
 - c. nuk është përcaktuar raporti i këmbimit të kuotave;
 - d. kuota e shoqërisë përthithëse SERE SH.P.K. nuk do të shpërndahen (caktohen) në një mënyrë të ndryshme, ndërsa kuotat që përbëjnë kapitalin themeltar të shoqërisë së përthithura BFI INVEST SH.P.K. të zotëruara tërësisht nga ortakët i vetëm shoqëria përthithëse, do të anulohen.
- sipas nenit 216, paragrafi 3, të Ligjit Tregtar, më datë 17 Korrik 2020 Raporti i Bashkimit me Përthithje është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (në vijim "QKR") me numër është CN-545708-0720-07-20, duke respektuar afatin kohor minimal të publikimit prej prej 30 (tridhjetë) ditësh të parashikuar me ligj.

Më tej, Kryetari shton se për efekt të bashkimit Shoqëria Përthithëse, SERE SH.P.K., do të përfshijë në pasurinë e saj të gjithë zërat aktivë dhe pasiv të Shoqërisë së Përthithur, BFI INVEST SH.P.K., duke marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë së Përthithur, duke zëvendësuar Shoqërinë e Përthithura në të gjitha raportet juridike të krijuara prej saj dhe duke u ofruar më tepër garanci ndaj të tretëve.

Për sa më sipër, Kryetari i propozon Asamblesë të marrë një vendim në lidhje me miratimin e Raportit të Bashkimit me Përthithje, kryerjen e bashkimit dhe autorizimin e administratorit të Shoqërisë për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për këtë qëllim.

Pasi pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes së parë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm,

VENDOS

- A. të miratojë Raportin e Bashkimit me Përthithje të nënshkruar më datë 1 Korrik 2020 nga administratorët e shoqërive BFI INVEST SH.P.K. dhe SERE SH.P.K., të regjistruar pranë QKB-së me datë 15 Korrik 2020 me numër është CN-545708-0720-07-20;
 - B. të miratojë nënshkrimin/ekzekutimin e marrëveshjes së bashkimit sipas kushteve të përcaktuara në Shtojcën E të Raportit të Bashkimit me Përthithje - Projekt-Marrëveshjen e Bashkimit mes Shoqërisë Përthithëse SERE SH.P.K. dhe Shoqërisë së Përthithur BFI INVEST SH.P.K.; dhe
 - C. të autorizojë administratorin e SERE SH.P.K., znj. Viola Kambellari, të ndërmarrë e të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme dhe/ose të dobishme për nënshkrimin dhe ekzekutimin e marrëveshjes së bashkimit me përthithje dhe/ose të emërojë përfaqësues të posaçëm në kufijtë e kompetencave të tij për këtë qëllim.
- 2. MIRATIMI I GARANCIVE PËR KREDITORËT EVENTUAL DHE SHKARKIMI I ADMINISTRATORËVE NGA ÇDO PËRGJEGJËSI**

Në lidhje me çështjen e dytë në Rend të Ditës, Kryetari parashtron se në përputhje me nenin 221 të Ligjit Tregtar për të shmangur çdo kundërshtim të mundshëm të bashkimit me përthithje nga kreditorët do të ishte oportune që secili prej përfaqësuesve ligjorë të shoqërive të përfshirë në bashkim të lëshonte të gjitha garancitë e nevojshme e të kërkuara sipas nenit 221 të Ligjit Tregtar. Në të kundërt, do të ekzistojë rreziku

potencial që kreditorët eventual të shoqërive të përfshira në këtë bashkim të kërkojnë anulimin e bashkimit për shkak të mosdhënies së garancive të parashikuara në ligj.

Duke marrë parasysh sa më sipër, Kryetari i propozon Asamblesë të marrë vendim në lidhje me (i) miratimin e dhënies së garancive nga administratori i Shoqërisë sipas nenit 221 i Ligjit Tregtar dhe, rrjedhimisht, autorizimin e administratorit të Shoqërisë për kryerjen e të gjitha veprimet e nevojshme për këtë qëllim, si dhe (ii) të përjashtojë administratorin e Shoqërisë nga çdo përgjegjësi në lidhje me sa më sipër.

Pasi një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes së dytë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm

VENDOS

- A. të miratojë dhënien e garancive të përcaktuara në nenin 221 të Ligjit Tregtar;
- B. të autorizojë administratorin e SERE SH.P.K., znj. Viola Kambellari, të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme dhe/ose të dobishme për dhënien e garancive në fjalë dhe/ose të emërojë përfaqësues të posaçëm në kufijtë e kompetencave të tij për këtë qëllim;
- C. të përjashtojë në mënyrë të pakthyeshme administratorin e Shoqërisë, zbj. Viola Kambellari, nga çdo përgjegjësi (duke përfshirë, por pa u kufizuar, në përgjegjësinë e parashikuar në nenin 221, paragrafi 3, dhe nenin 224 të Ligjit Tregtar), (i) duke u angazhuar t'a mbajë të përjashtuar dhe të pacënuar nga çdo veprim gjyqësor i ndërmarrë ndaj tij, përgjegjësi dhe pasojë e karakterit pasuror (duke përfshirë këtu shpenzimet e asistencës ligjore, shpenzimet dhe mbrojtjen gjyqësore) me objekt veprimtarinë e tij në kuadër të operacionit të bashkimit në fjalë (duke përfshirë, por pa u kufizuar, në dhënien e garancive të përcaktuara në nenin 221 të Ligjit Tregtar) dhe, më tej, (ii) duke hequr dorë në mënyrë të pakthyeshme nga çdo pretendim, e drejtë dhe/ose kërkesë padi që Shoqëria mund të ngrejë në raport me të për veprime apo mosveprime që kanë të bëjnë me bashkimin në fjalë (duke përfshirë, por pa u kufizuar, në dhënien e garancive të përcaktuara në nenin 221 të Ligjit Tregtar).

3. TË NDRYSHME

Në lidhje me çështjen e fundit në Rend të Ditës Presidenti u referon të pranishëmve se në zbatim të legjislacionit shqiptar është i detyrueshëm regjistrimi i vendimit të kësaj Asambleje pranë QKB-së për efekt të perfeksionimit të marrëveshjes së bashkimit miratuar në nënpikën (B), të çështjes së parë, në Rend të Ditës dhe, nëse do të jetë e nevojshme, pranë organeve të tjera administratës publike shqiptare dhe propozon që Asambleja të autorizojë një person për këtë qëllim.

Pasi shqyrtimit të çështjes së tretë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm

VENDOS

të autorizojë administratorin e SERE SH.P.K., znj. Viola Kambellari, të ndërmarrin, të gjitha veprimet dhe/ose procedurat e nevojshme, të bëjnë kërkesa dhe të nënshkruajë çdo dokument të kërkuar me qëllim depozitimin e këtij vendimi dhe të dokumentacionit bashkëlidhur pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit apo pranë çdo organi tjetër të administratës publike, si dhe të autorizojnë persona të tjerë për këtë qëllim.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 14.30.


Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakut te Vetëm të "Albanian Energy Supplier" Shpk mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

KRYETARI


Znj. Edlira Muka



SEKRETARI


Znj. Itena Ndroqi

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
BFI INVEST SH.P.K.
RR. PAPA GJON PALI II, ABA BUSINESS CENTER, KATI 11TË
TIRANË, SHQIPËRI
L51721007Q

VENDIM

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 24.08.2020, në orën 10.00, në selinë qendrore të **BFI Invest Sh.p.k.**, regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi L51721007Q (më tej referuar si "**Shoqëria**"), me adresë Tirane, Rruga Papa Gjon Pali II, Ndertesa Nr.12, Kati 11 u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me të pranishëm:

- **Balfin Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT K72223031K dhe seli në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center, Kati 11, Tiranë, përfaqësuar nga administratori i saj **Znj.Edlira Muka**, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 03.02.1983, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e lëtëmjoftimit me Nr. 034271384, - ortake e Shoqërisë dhe zotëruese e 100% (njëqind për qind) të kuotave të kapitalit themeltar të saj;

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton **znj. Itena Ndroqi** e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaroi Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim

RENDI I DITËS

1. **Miratimin e Bashkimit me Përthithje mes shoqërisë përthithëse SERE SH.P.K. dhe shoqërisë së përthithur BFI INVEST SH.P.K;**
2. **Miratimi i garancive për kreditorët eventual dhe shkarkimi i administratorëve nga çdo përgjegjësi; dhe**
3. **Të ndryshme.**

1. **Miratimin e Bashkimit me Përthithje mes shoqërisë përthithëse SERE SH.P.K. dhe shoqërisë së përthithur BFI INVEST SH.P.K;**

Duke kaluar në diskutimin çështjes së parë të Rendit të Ditës, Kryetari u kujton të pranishëmve se:

- **BFI INVEST SH.P.K.** zotëron 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë **SERE SH.P.K.**;
- në datë 1 Korrik 2020, administratori **BFI INVEST SH.P.K.** sëbashku me administratorin e shoqërisë **SERE SH.P.K.**, kanë nënshkruar raportin e bashkimit me përthithje, sipas të cilit Shoqëria do të përthithë shoqërinë të kontrolluese **BFI INVEST SH.P.K.**, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi (në vijim "**Raporti i Bashkimit me Përthithje**")
- sipas Raportit të Bashkimit me Përthithje, bashkimit synon reduktimin e kostove të administrimit dhe optimizmin në tërësi të pasurive/mjeteve të shoqërive të përfshira në këtë operacion;



- sipas nenit 225, paragrafi 2, i Ligjit nr. 9901, me datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (në vijim "Ligji Tregtar") dhe në veçanti, sikurse rezulton nga projekt marrëveshja e bashkimit dhe vendimet e asambleve përkatëse, duke qenë se bëhet fjalë për një formë të tërthortë bashkimi:
 - a. nuk do të ketë ndryshime në statutit të shoqërisë përthithëse;
 - b. kapitalit i shoqërisë përthithëse do të zmadhohet në vlerën 5,000,000 Lekë ;
 - c. nuk është përcaktuar raporti i këmbimit të kuotave;
 - d. kuota e shoqërisë përthithëse SERE SH.P.K. nuk do të shpërndahen (caktohen) në një mënyrë të ndryshme, ndërsa kuotat që përbëjnë kapitalin themeltar të shoqërisë së përthithura BFI INVEST SH.P.K. të zotëruara tërësisht nga ortaku i vetëm shoqëria përthithëse, do të anulohen.
- sipas nenit 216, paragrafi 3, të Ligjit Tregtar, më datë 17 Korrik 2020 Raporti i Bashkimit me Përthithje është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (në vijim "QKR") me numër ështëjeje CN-545708-0720-07-20, duke respektuar afatin kohor minimal të publikimit prej prej 30 (tridhjetë) ditësh të parashikuar me ligj.

Më tej, Kryetari shton se për efekt të bashkimit Shoqëria Përthithëse, SERE SH.P.K., do të përfshijë në pasurinë e saj të gjithë zërat aktivë dhe pasiv të Shoqërisë së Përthithur, BFI INVEST SH.P.K., duke marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë së Përthithur, duke zëvendësuar Shoqërinë e Përthithura në të gjitha raportet juridike të krijuara prej saj dhe duke u ofruar më tepër garanci ndaj të tretëve.

Për sa më sipër, Kryetari i propozon Asamblesë të marrë një vendim në lidhje me miratimin e Raportit të Bashkimit me Përthithje, kryerjen e bashkimit dhe autorizimin e administratorit të Shoqërisë për të ndërmarrë të gjitha verimet e nevojshme për këtë qëllim.

Pasi pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes së parë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm,

VENDOS

- A. të miratojë Raportin e Bashkimit me Përthithje të nënshkruar më datë 1 Korrik 2020 nga administratorët e shoqërive BFI INVEST SH.P.K. dhe SERE SH.P.K., të regjistruar pranë QKB-së me datë 15 Korrik 2020 me numër ështëjeje CN-545708-0720-07-20;
 - B. të miratojë nënshkrimin/ekzekutimin e marrëveshjes së bashkimit sipas kushteve të përcaktuara në Shtojcën E të Raportit të Bashkimit me Përthithje - Projekt-Marrëveshjen e Bashkimit mes Shoqërisë Përthithëse SERE SH.P.K. dhe Shoqërisë së Përthithur BFI Invest sh.p.k.; dhe
 - C. të autorizojë administratorin e BFI Invest sh.p.k., znj. Ardiana Sokoli, të ndërmarrë e të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme dhe/ose të dobishme për nënshkrimin dhe ekzekutimin e marrëveshjes së bashkimit me përthithje dhe/ose të emërojë përfaqësues të posaçëm në kufijtë e kompetencave të tij për këtë qëllim.
2. **MIRATIMI I GARANCIVE PËR KREDITORËT EVENTUAL DHE SHKARKIMI I ADMINISTRATORËVE NGA ÇDO PËRGJEGJËSI**

Në lidhje me çështjen e dytë në Rend të Ditës, Kryetari parashtron se në përputhje me nenin 221 të Ligjit Tregtar për të shmangur çdo kundërshtim të mundshëm të bashkimit me përthithje nga kreditorët do të ishte oportune që secili prej përfaqësuesve ligjorë të shoqërive të përfshirë në bashkim të lëshonte



të gjitha garancitë e nevojshme e të kërkuara sipas nenit 221 të Ligjit Tregtar. Në të kundërt, do të ekzistojë rreziku potencial që kreditorët eventual të shoqërive të përfshira në këtë bashkim të kërkojnë anulimin e bashkimit për shkak të mosdhënies së garancive të parashikuara në ligj.

Duke marrë parasysh sa më sipër, Kryetari i propozon Asamblesë të marrë vendim në lidhje me (i) miratimin e dhënies së garancive nga administratori i Shoqërisë sipas nenit 221 i Ligjit Tregtar dhe, rrjedhimisht, autorizimin e administratorit të Shoqërisë për kryerjen e të gjitha veprimet e nevojshme për këtë qëllim, si dhe (ii) të përjashtojë administratorin e Shoqërisë nga çdo përgjegjësi në lidhje me sa më sipër.

Pasi një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes së dytë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm

VENDOS

- A. të miratojë dhënien e garancive të përcaktuara në nenin 221 të Ligjit Tregtar;
- B. të autorizojë administratorin e Shoqërisë, znj. Ardiana Sokoli, të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme dhe/ose të dobishme për dhënien e garancive në fjalë dhe/ose të emërojë përfaqësues të posaçëm në kufijtë e kompetencave të tij për këtë qëllim;
- C. të përjashtojë në mënyrë të pakthyeshme administratorin e Shoqërisë, znj. Ardiana Sokoli, nga çdo përgjegjësi (duke përfshirë, por pa u kufizuar, në përgjegjësinë e parashikuar në nenin 221, paragrafi 3, dhe nenin 224 të Ligjit Tregtar), (i) duke u angazhuar t'a mbajë të përjashtuar dhe të pacënuar nga çdo veprim gjyqësor i ndërmarrë ndaj tij, përgjegjësi dhe pasojë e karakterit pasuror (duke përfshirë këtu shpenzimet e asistencës ligjore, shpenzimet dhe mbrojtjen gjyqësore) me objekt veprimtarinë e tij në kuadër të operacionit të bashkimit në fjalë (duke përfshirë, por pa u kufizuar, në dhënien e garancive të përcaktuara në nenin 221 të Ligjit Tregtar) dhe, më tej, (ii) duke hequr dorë në mënyrë të pakthyeshme nga çdo pretendim, e drejtë dhe/ose kërkesë padi që Shoqëria mund të ngreje në raport me të për veprime apo mosveprime që kanë të bëjnë me bashkimin në fjalë (duke përfshirë, por pa u kufizuar, në dhënien e garancive të përcaktuara në nenin 221 të Ligjit Tregtar).

3. TË NDRYSHME

Në lidhje me çështjen e fundit në Rend të Ditës Kryetari u referon të pranishëmve se në zbatim të legjislacionit shqiptar është i detyrueshëm regjistrimi i vendimit të kësaj Asambleje pranë QKB-së për efekt të perfeksionimit të marrëveshjes së bashkimit miratuar në nënpikën (B), të çështjes së parë, në Rend të Ditës dhe, nëse do të jetë e nevojshme, pranë organeve të tjera administratës publike shqiptare dhe propozon që Asambleja të autorizojë një person për këtë qëllim.

Pasi shqyrtimit të çështjes së tretë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm

VENDOS

të autorizojë administratorin e znj. Ardiana Sokoli të ndërmarrin, të gjitha veprimet dhe/ose procedurat e nevojshme, të bëjnë kërkesa dhe të nënshkruajë çdo dokument të kërkuar me qëllim depozitimin e këtij vendimi dhe të dokumentacionit bashkëlidhur pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit apo pranë çdo organi tjetër të administratës publike, si dhe të autorizojnë persona të tjerë për këtë qëllim.




Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 14.30.

KRYETARI


Znj. Edlira Muka



SEKRETARI


Znj. Itena Ndroqi